



Informatë për shtyp - 321/04/2020

27.04.2020
faqe 1 nga 2

Bilanc i përkohshëm pas një muaji i programit të ndihmës së menjëhershme në NRW

Zyra e Shtypit të Kancelarisë
Shtetërore
40213 Düsseldorf
Telefon 0211 837-1134
0211 837-1405
oder 0211 837-1151

presse@stk.nrw.de
www.land.nrw

Ministri Pinkwart: Landi dhe Federata kanë ndihmuar financiarisht me 3,5 miliard Euro 331.000 biznese të vogla, punonjës me honorar dhe biznese-solo - përpunimi mesatar i aplikimeve: tetë ditë

Ministria për Ekonomi, Inovacion, Digitalizim dhe Energji informon:

Qindra mijëra biznese të vogla, punonjës me honorar dhe biznese-solo në Nordrhein-Westfalen kanë marrë si përkrahje financiare më shumë se 3,5 miliardë që ta tejkalojnë krizën. Këtë bilanc e ka tërhequr ministri i Ekonomisë dhe Digitalizimit prof. dr. Andreas Pinkwart vetëm një muaj pas fillimit të programit të ndihmës së menjëhershme në NRW. Vetëm në ditët e kaluara kanë arritur 39.000 aplikime, pagesa e të cilave është bërë në dy këste në një shumë prej 400 milionëve. Kështu që më shumë se 80 përqind e aplikimeve, të cilat kanë arritur me numër të saktë të tatimit janë shqyrtuar dhe kanë marrë shumën e caktuar.

Ministri Pinkwart: „Ndhima e menjëhershme e NRW është programi më i madh ekonomik i deritashëm në Nordrhein-Westfalen. Aq shpejt sa ka ardhur kriza e koronës, po aq shpejt kemi vepruar. Për ndihmën e menjëhershme në NRW kanë arritur në muajin e kaluar 417.000 aplikime. Këto dimensione mund të kryhen vetëm me partnerët e fortë: Për këtë arsye kemi zhvilluar një proces digital nga fillimi deri në fund dhe atë brenda pak ditëve me administratën e Qarqeve, IT.NRW, administratën e tatimeve dhe odat tjera, me qëllim që ndihma të arrijë shpejt dhe sigurtë: 80 përqind e aplikimeve kanë marrë ndihmë në gjyrollogarinë e tyre brenda një kohe mesatare prej tetë ditësh. Këtë tempo duam ta mbajmë.“

Në të njëjtën kohë landi po punon në gjetjen e një zgjidhje, që bizneset-solo, për mbulimin e hargjimeve jetësore të aplikojnë sipas federatës për sigurinë themelore dhe jo për programin e ndihmës së menjëhershme. Sipas dëshirës së shumicës së landeve të prekurit nga kjo duhet të vendosin vetë, se cilën ndihmë duan të zgjedhin, ndihmën themelore apo programin e ndihmës së menjëhershme.

Ministri: „Propozimi jonë ka gjetur përkrahje të shumicës dhe atë përtej partiake në konferencën e ministrave të ekonomisë. Ministri i Financave Lutz Lienenkämper do të angazhohet të enjten në konferencën e ministrave të financave për të gjetur një zgjidhje të shpejt dhe jo byrokratike për bizneset-solo.“

Ndihmën e menjëhershme do ta marrin shumë shpejt edhe bizneset e reja, të cilat i kanë ofruar produktet dhe shërbimet e tyre pas 31.12.2019. Ata mund të aplikojnë me ndihmën e këshilltarit të tyre për tatim, nëse kanë arritur të krijojnë të hyra deri më 11.03.2020 dhe nëse kanë porosi ose kanë krijuar një detyrim afatgjatë të pagesave të biznesit të tyre. Puna në formular dhe në dakordimin e nevojshëm me të gjithë pjesëmarrësit në këtë proces është duke u bërë.

Në rast se keni pyetje drejtohuni tek zyra për shtyp e Ministrisë për Ekonomi, për Inovacion, Digitalizim dhe Energji, telefoni (Matthias Kietzmann). 0211 61772-204

Ky tekst i shtypit mund të gjendet përmes faqes së internetit të Qeverisë së Landit www.land.nrw

[Udhëzime për mbrojtjen e datave lidhur me mediat sociale](#)